

Shënim hyrës

Gazeta Albania një gazetë thellësisht politike, tashmë e mbyllur. Zotëroi për një kohë relativisht të gjatë peshë në shtypin shqiptar për shkak të problematikës që trajtonte sidomos në aspektin e problemeve kombëtare.

Në këtë gazetë botova 7 artikuj, 24 faqe dhe me shtrirje kohore prej 2006-2010. Tematika e shkrimeve të mia lidhen kryesisht me problemet e hasura në Minoritetin Etnik Grek dhe marrëdhëniet midis dy vendeve. Midis të tjerash atakohet ashpër nacionalizmi shqiptar dhe pengmarrja në emër të tij të MEG, si edhe politika për tjetërsimin e pronësisë mbi tokën në Himarë. Nënvizohet gjithashtu qëndrimi dyshues dhe abuzues i lidershit të PBDNJ-së me MEG, sidomos në Himarë.

Εισαγωγή

Η εφημερίδα Albania, μια εφημερίδα με έντονο πολιτικό περιεχόμενο, δεν κυκλοφορεί πλέον από χρόνια. Για αρκετά επίσης χρόνια κατείχε σημαντική θέση στον αλβανικό τύπο, λόγο του προβληματισμού σε πολιτικό και αλβανικό εθνικό επίπεδο .

Στην εφημερίδα αυτή δημοσίευσα 7 άρθρα, 24 σελίδες και σε χρονική διάρκεια από το 2006-2010. Ο προβληματισμός της αρθρογραφίας μου αφορούσε κατεξοχήν θέματα στην Εθνική Ελληνική Μειονότητα και τις διμερείς σχέσεις. Μεταξύ των άλλων κοντράρουν σκληρά τον αλβανικό εθνικισμό και η ομηρία εξ ονόματός του της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, καθώς και η πολιτική αλλοίωσης των περιουσιακών στοιχείων, ιδιαίτερα στη Χιμάρα. Υπογραμμίζεται επίσης η αμφίβολη και καταχραστική θέση της ηγεσίας του ΚΕΑΔ σε σχέση με την ΕΕΜ, ιδιαίτερα στο θέμα της Χιμάρας

PERMBAJTJA

- 1. Antigreqizmi nuk ndihmon as nacionalizmin shqiptar as marrëdhëniet ndërshtetërore**
(E vërteta e reportazhit në televizionin grek NET)
25.12.2006 /26.12. faq. 3.
- 2. Rreziqet që vijnë nga qëndrimi i PBDNj-së që Himarëa është greke vetëm në Greqi dhe jo e tillë në Shqipëri**
i. (Përse Dule luan me Himaren)
21.01.2007/23.01.2007 faq. 6.
- 3. Berisha e mashtroi për president, Nanua kërcenon dhe zbulon natyrën e vet dhe të politikës shqiptare**
07.04.2007 faq. 9.
- 4. Pushteti politik i Berishës dhe tjetërsimi në emër të tij të pasurisë pronësore, -rasti i Himarës dhe Bregut**
22.04.2007 / 24.04.2007 fq 1-10 faq. 11.
- 5. Minoriteti Etnik Grek, po mirret pengë i interesave nacionaliste shqiptare që u intereson defaktorizimin e tij.**
(Ku kullot kali i Trojës)
23.04.2007/25.04.2007 faq. 14.
Μετάφραση ελληνικά faq. 17.
- 6. Ne pritje të barbareve, apo barbarët mbeten vetëm**
17.10.2007 faq. 21.
- 7. Në mbrojtje të qytetarisë.**
09.05.2010 / 11.05.2010 faq. 23.
- 8. Fund** faq. 24

Nga Panajot Barka

Antigreqizmi nuk ndihmon as nacionalizmin shqiptar as marrëdhëniet ndërshtetërore

25.12.2006 / 26.12.2006



Të dielën me 24 dhjetor, prag krishtlindjesh, gazeta “Albania” hapet në faqen e parë me titullin “TV-shtetëror grek: “Myslimanet Shqiptarë janë Turq”. Në okelio: “Reportazh i TV NET në Dropull: “Tokat e jugut, trojet greke”. Dhe në nëntitull: “Citohen dropullit: “Lazarati banohet nga turq, nuk përzihemi me ta””. Ideja dhe përkthimi nga Panajot Barka. (!!)

Bëhet fjalë për një shkrim të një Jakup Gjoça nga Athina të botuar në faqën 5 të kësaj gazete. Besoj se nuk mund “të gjendet dhuratë” më e mirë të kësaj gazete për krishtlindjet (gazeta nuk botohet të henën), për harmoninë ndërjetare në vend, për marrëdhëniet ndëretnike në jug të vendit, por edhe për marrëdhëniet midis dy vendeve

Shqipërisë dhe Greqisë. Tregues për këtë është fakti që në Gjirokastrë; qytet ku edhe për Krishtlindje, ashtu si për festat e tjera të krishtera, nuk kishte urime publike, siç ndodh për festat myslimane; gazeta u shit brenda disa minutave.

Shkas për shkrimin në “Albania” u bë një emisioni udhëtimi në një nga kanalet publike greke me temë nga minoriteti etnik grek në Shqipëri, transmetuar më datë 18 të këtij muaji. Qëllimi i këtij emisioni dokumentar, si pjesë e një cikli disa vjeçar me udhëtime të panumërta në shumë vende të botës të drejtuesës së tij, gazetarës Maja Tsokli, ishte të sillte në vëmendjen e shikuesve grek realitetin në minoritetin etnik grek në Shqipëri, me problemet, jetën, traditat, kulturën e tij, si një vertetim i pohimit aq të hasur jo vetëm në këtë emision se ky minoritet edhe pse në vijim të kombit am, është aq i panjohur dhe aq larg nga ai. Në tërësi emisioni iu shmang problematikës në marrëdhëniet me shtetin shqiptar duke i mëshuar identitetit të këtij minoriteti dhe marrëdhënieve me kombin am.

Mirëpo, artikullshkruesi tek “Albania” gjen te ky emision një “skenar të mirëpërgatitur për të promovuar politikën zyrtare shoviniste greke” ndaj Shqipërisë. Argument për këtë deduksion përbën fakti që njëzë të thjeshtë e të rastësishëm në Dropull, (autori i shkrimit lë hapur të kuptohet se janë përzgjedhur enkas paraprakisht) e quajnë vetën “grek” (dhe jo më minoritarë, apo edhe minoritarë grek si në kohën e diktaturës). Se ata deklaroronin para kameras se jetojnë në trojet e tyre dmth se janë autoktonë. (ata guxojnë të thyejnë tabut e të veçtetave të paverifikueshme të sistemit komunist se “minoritarët” janë të ardhur në këto troje aty nga shekulli XVII ose XVIII dhe se “bujaria e shtetit shqiptar, në pasuri e të drejta ndaj tyre është pa limit”). Autori i shkrimit tek “Albania” nuk sjell asnjë argument kundër këtij realiteti në minoritetin etnik grek, ose një detaj të vetëm që të provojë se kush janë banorët para tyre në këto troje. Thjesht mbeshtetet te pesha e propagandës komuniste për të akuzuar palën greke (duke përfshirë anëtarët e minoritetit grek, medjat greke deri te politika zyrtare greke) për shovinizëm dhe për të

mbajtur ndezur nacionalizmin shqiptar. Për të qenë më bindës autori i shkrimit shkon shumë larg kur këto deklarata i servir si fakte që venë në dyshim terrësinë territoriale të shteti shqiptar. Kjo është tëpër e rrezikshme dhe provokative po të kihet parasysh se askush nga të intervistuarit “minoritarë” nuk vuri në dyshim terrësinë territoriale të shtetit shqiptar edhe kur thonë se minoriteti etnik grek në Shqipëri përbën një vazhdimësi natyrale gjeografike kombit am. Provokativ dhe i rrezikshëm është edhe fakti që një detaj i thenë me gjysëm zëri dhe i kundërshtuar nga gazetarja gjatë bisedës së saj me një të ri nga Derviciani për marrëdhëniet me fqinjët e tij nga Lazarati, fokusohet në shkrim dhe në gazetë si një zbulim për të vertetuar se politika zyrtare greke në marrëdhëniet me fqinjët shqiptarë udhëhiqet akoma nga parimet e kohës së perandorisë otomane të “rum milletit” ku myslimanet konsideroheshin turq dhe ortodokset grek. Kjo është një tezë që konsumohet shpesh në medjat shqiptare dhe kuptohet që ngjall ilaritet. Në rastin në fjalë përgjithësimi i një gjysëm fjalie të një njëri anonim që më siguri ka më shumë miq në Lazarat se sa në Greqi, është një urrë zjarri në marrëdhënjet midis dy komuniteteve me etni e fe të ndryshme ngjitur me njëri-tjetrin por edhe për marrëdhëniet në nivele e plane të tjera midis shqiptarëve e grekëve.

Lë të mos harrojmë se xhirimet për këtë emision dokumentar për minoritetin grek në Shqipëri u bënë në verën e vitit 2004, pak pas përfundimit Evrofutbollit, ku Greqia u shpall kampione dhe minoritarët grek në Shqipëri nuk u lanë të manifestonin për fitorën e ekipit të kombit të tyre. Madje ndodhen dhe incidente të rënda që për hir të mirëkuptimit u kapërxyen. Kuptohet që emisioni nuk ishte jehonë e kësaj atmosfere. Por deklarata e të riut nga Derviciani domosdo që po.

Në këto rrethana artikulli i ngjan një mbledhjeje të qëmotshme të Frontit Demokratik të lagjës për të demaskuar “armiqtë e popullit që folën kundër udhëheqjes”. Një nga ata në shkrim jam edhe unë. Sqarohet, edhe pse nuk jam i detyruar, se prania ima në këtë emision lidhet me faktin e të qenit korrespondent në të njëjtin institucion mediatik. Ishte një përvojë në shumë drejtime, vëçanërisht në aspektin e përgjegjësisë profesionale dhe etikës së gazetarit si pjesë e saj. Por më shumë që një imponim ndaj vetës për të respektuar profilin e emisionit dhe të vet gazetarës për të ngritur një emision në bazë të ndjekjes, eksplorimit dhe hulumtimit në mënyrë spontane dhe të natyrshëm të çdo detaji, për të dalë në “përfundime” që rrjedhin nga ekspozimi i tyre. Siç e thamë emisioni ishte pjesë e udhëtimit të gazetarës greke Maja Tsokli në çdo skaj të botës, në vende me histori dhe kulturë të lashtë, me konflikte nga më të nxehura, me varfëri të skajshme, apo që paraqesin interes njohjeje të çfarëdollojshme. “Arma” e vetme e zonjës Tsokli, vajzës së një piktori nga më të famshëm të Greqisë, për të përballuar çdo situatë të pakëndshme dhe të vështirë, është kultura e gjerë e skalitur te buzëqeshja, mirëkuptimi dhe aftësia për t’i komunikuar me një veshtrim edhe bashkëbiseduesit më të vështirë, dyshues dhe të paragjykuar, sigurinë se prej saj nuk i vjen asnjë e keqe. Në këto rrethana, vetëm nëse duhet të pranosh se do të marrësh si shpërblim përçmimin e saj do të pranosh rolin e “ideatorit” në punën e vet. Vetëm një mendje shpellarësh mund të pranojë dhe të paragjykojë këtë gazetare kozmopolite, këtë vajzë që për lirinë dhe autortetin e saj mohoi mbeshtetjen e staturës dhe famën e babait të vet, se merr përsipër misionet e qarqeve nacionaliste greke. Vetëm një medjokër në punët e demokracisë e të lirisë së shtypit, apo një mashtrues që abuzon me fuqinë e shypit për të nxitur urrejtje, mund të pranojë se politika zyrtare greke mund të mbeshtetet në forma të tilla gazetaresh për të bërë “politikë nacionaliste”. Apo se politika zyrtare greke është e unifikuar me medjen. Dhe emisioni e tregon qartë këtë.

Si përfundim do të thoshja që ky shkrim nuk është gjë tjetër veçse pjesë e atyre shkrimeve që shesin për patriotizëm antigreqizmin si mjet për forcimin e nacionalizmit shqiptar. Fatkeqësisht ky mentalitet që i shërbeu, për arsye që mund të konsiderohen të

drejta, ideologjisë kombëtare shqiptare të një periudhe 150 vjet më parë, thirret në ndihmë të nacionalizmit ende sot. Madje, gjithmonë e më shumë po dalin në dritë “teoricien” nga Shqipëria, që në emer të këtij mentaliteti nacionalist, marrin përsipër për të ringritur në kembë teza të vdekura të Falmerayerit të shekullit të XIX dhe të para Luftës së II Botërore, se grekërit e sotëm nuk kanë asnjë lidhje me grekërit e lashtë. Nuk dua të përmend këtu proverbin e njohur “se u vjen keq për kalorësin që i varen këmbët”, por të shpreh keqardhjen se ky mentalitet edhe pse po rrezikon të kthehet në bumerang për vet emancipimin shoqëror e nacional të Shqipërisë, nuk po kundërshtohet. Madje, i pashpresë duket në kambanat e tij dhe vet Kadareja. (Kohët e fundit një grup aktivistësh grek, përkrahës të hapur të shqiptarëve, të cituar dhe në medjat shqiptare, kërkuan që të kontaktojnë me homolog shqiptarë përkrahës dhe ata të Greqisë dhe të grekërve. Gjeten të tillë aq sa tepruan shumë nga gishtat e njërës dorë) Kjo do të thotë se kjo situatë nuk po marginalizon vetëm minoritarët grek në Shqipëri, (artikulli i “Albanies” shkon akoma me tutje duke ndezur vatra zjarri me emra e vende konkrete). As marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Por ka faktorë që synojnë të mbajnë të marginalizuar e të distancuar nga shoqëria greke edhe emigrantet shqiptarë në Greqi. Në një letër të një emigranti të botuar në gazetën “SOT” datë 22.12.2006, thuhet fare hapur se medjat në Shqipëri u kërkojnë korrespondentëve të tyre në Greqi që të evidentojnë vetëm anët e zeza të jetës dhe të marrëdhënieve të tyre me shoqërinë greke. Ndërkohë ai pranon të kundërtën dhe numëron në letrën e tij me dhjetra shoqata emigrantesh shqiptarë, kryesisht intelektualësh, që veprojnë në Greqi dhe po aq aktivitete të organizuara ditët e fundit në Greqi për nder të festës kombëtare të Shqipërisë. Asnjë lloj nacionalizmi grek aq me tëpër shtetëror nuk po i kundërvihet. Atëherë..... Mos po mbetemi me kokën kthyer prapa. (!?)

Panajot Barka

Për gazetën Albania datë 25.12.2006. U botua me 26.12.2006 (Është e arshivuar).

**Rreziqet që vijnë nga qëndrimi i PBDNJ-së që Himara është greke
vetëm në Greqi dhe jo e tillë në Shqipëri**
(Përse Dule luan me Himaren)

21.01.2007/23.01.2007

Të shtunën, në ditën e parë të takimeve zyrtare elektorale të partive politike me zgjedhësit, Partia e të Drejtave të Njëriut u prezantua me incidentin e parë elektoral, në atë që konsiderohet pika e nxehtë e zgjedhjeve, -Himara.

Lajmi në lidhje me incidentin ishte pak a shumë kështu. Disa persona tre në numër, “të revoltuar” për faktin se PBDNJ-shi hapi fushatën elektorale në Himarë me fjalime në gjuhën greke të cilave u parapriu hymni kombëtar grek, tentuan të prishin tubimin e Partisë së Dulës. Në këtë përpjekje ata, duke bërëtitur parulla pro kryeministrit Berisha dhe autoriteteve të tjera të larta qeveritare dhe kundër Dulës e kryetarit aktual të bashkisë së Himarës, Bollano, u konfrontuan me manifestuesit të Dulës. Për pasojë pati plagosje të lehta dhe tre persona të shoqëruara në polici.

Komentet e para të ardhura nga PBDNJ-ja ishin se incidenti kishte prapavijë politike pa i venë gishtin ndonjë subjekti të caktuar politik dhe se personat “keqbërës” janë të njohur në Himarë për aktivitetet e tyre të dyshimta dhe të paligjshme, por të mbrojtur nga shteti.

Lajmi dhe komenti deri këtu nuk do të bëheshin shkas për shkrimin në fjalë. Ose mund të lidhet me një analizë kundër incidenteve të tilla që, për arsye të njohura, marrin një ngjirim tjetër kur ndodhin në Himarë me precedente edhe më të rënda në të kaluarën. Kuptohet edhe një analizë e tillë ka rëndësinë e vet. Por, objekti i këtij shkrimi lidhet me komentin që i bëri si kryetari i PBDNJ-së Dulja, ashtu dhe kryetari i Bashkisë së Himarës Bollano, faktit nëse mitingu, ose në miting u përdor gjuha greke. Dulja e konsideroi këtë fakt, sipas medjave, “një përrallë” dhe Bollano, në fillim thjesht e mohoi e më pas deklaroi se “kush nuk di greqisht në Himarë”(!). Pra, problemi është tepër i thjeshtë. Pse lidhshipi i PBDNJ-së i shmanget publikimit të faktit se në miting u përdor gjuha greke! Është e kundër ligjshme? Në rast se jo, atëherë pse e shmang për opinionin e gjerë këtë fakt. Në rast se po, pse e aplikon. Po ashtu, në rast se pati njëanshmeri, pra prania e elementit grek shpërfillte domosdoshmerinë e pranisë së elementit shqiptar, ose ligjin elektoral, pse u lëjua. Po ashtu, në rast se elementi “i irrituar” nga përdorimi i greqishtes, u nxit nga dikush për të thenë se “ata janë shqiptarë” dhe në xhep edhe ata mbajnë kartën e identitetit të të qenit homogjen grek, atëherë kush fshihet pas këtyre mitingashëve dhe çfarë do të arrijë. Të pohojë vertet një realitet të kundërt nga ai i promovuar në mitingun e PBDNJ-së apo të martirizojë lidhshipin e kësaj partie. Pra momenti sjell në pah një problematikë që një orë e më parë duhet të sqarohet dhe nga ana tjetër lëjohet në këtë formë që të abuzohet.

Momenti në fjalë, kuptohet që buron në radhë të parë nga dyfytërsia politike e Partisë së Dulës dhe për këtë problem. PBDNJ-ja dhe OMONIA e konsideruan fitoren e nënkryetarit të OMONIAS Vasil Bollano në 2003 në Himarë, si argument bindës të vertetësisë se bashkia e Himarës është pjesë e pandarë e zonave të tjera të minoritetit grek në Shqipëri, të mohuar nga sistemi komunist dhe të papranuar në të gjitha nivelet e realitetit të sotëm në Shqipëri. Në këtë aspekt pati vlerë edhe raporti i organizmave ndërkombëtare në lidhje me zgjedhjet vendore të atëhershme që përmendte në mënyrë taksative praninë në Himarë të një komuniteti grek. Shndërrimin në simbol të helenizmit në Himarë të një kryetari bashkie (të fituar nga PBDNJ-ja në saj edhe të aleancës me PD-në), e favorizoi dhe beteja pa arsye dhe incidentet tepër të rënda të shkaktuara nga ato forca e qarqe që e konsideronin këtë zgjedhje si goditje e rëndë për

nacionalizmin shqiptar dhe pjesë e strategjisë helenizuese të Greqisë ndaj të jugut të Shqipërisë. (!)

Argumenti u përdor me mjeshtri nga lidershipi i PBDNJ-së në ambjentet helene për të vertetuar “aftësitë” e tij në “kurrorëzimin me sukses të betejave për çeshtje të rendësishme dhe të veshitura të karakterit etnik”. Me këtë argument dhe duke mbajtur në këto qarqe për dore Bollanon, Dulja kërkoi të zgjaste jetëgjatësinë e tij në rolin e “një udhëheqësi” largpamës etnik.

Përse e theksojmë këtë. Për arsye se ai asnjëherë nuk artikuloi të njëjtën gjë në qarqet shqiptare. Nuk e ndihmoi për të nënkuptuar faktin se Himara është greke as gjuha ezopike e përdorur prej tij. Ndërsa Bollano mjaftohej, ose duke thenë se për këtë duhej pyetur himarjotet, (që do të thotë se ai s kishte ide), ose i shmangej pyetjes duke thenë se nuk ishte momenti, ose duke folur thjesht për vetën etij.

Të njëjtën gjë benë këta dy zotërinjtë edhe me çeshtjen e shkollës private dygjuhëshe në Himarë. Në Greqi dhe në qarqe të tjera greke trumbetonin si sukses të tyre rihapjen pas pesë dekadash të shkollës greke në Himarë, (duke nënkuptuar një shkollë publike në gjuhën greke që do të saksiononte përkatësinë e Himarës në pjesën tjetër të minoritetit etnik grek në Shqipëri), ndërsa te Berisha kërkonte leje për shkollë private të administruar nga shoqata nën varësinë e PBDNJ-së (?!). Ashtu si edhe u bë. (Nuk mund të mos vihet re se referimet tek elementi grek në Himarë edhe kur pranohen në mjedisin shqiptar i jipet një ngjyrim tjetër nga të qenit pjesë përbërëse i etnisë greke. Dhe këtë e bën në këtë mjedis edhe lidershipi politik i PBDNJ-së dhe i OMONIAS)

Fakti që për Dulën Himara është greke vetëm kur ai ndodhet në qarqe greke dhe është jo greke kur ndodhet në mjedisin shqiptar e tregoi dhe rasti i mitingut të fundit. Në rast të kundërt ai nuk kishte asnjë arsye të mohonte faktin e përdorimit të gjuhës greke në një miting qoftë edhe elektoral. Këtë të drejtë ia garanton kushteta e vendit dhe konventa kuadër?! Ai pse ia mohon vetës. Dhe me keq akoma. Përderisa e përdori në miting gjuhën amtare pse del pastaj dhe përgënjeshton vetvetën. Nga kush fshihet zoti Dulja dhe te kush kërkon të mburet.

Pra loja e Dulës në këtë plan është e rrezikshme. E rrezikshme se ai u kap fort pas “yllit” të Himarës dhe mbeshteti pikërisht këtu gjithë avenirin e vet politik duke abandonuar dhe lenë mënjanë gjithë problematikën e pjesës tjetër të minoritetit etnik grek. Dhe po të kemi parasysh, vetëm faktin se femijët në shkollat publike në gjuhën amtare në minoritetin grek, nuk kanë asnjë tekst mësimor në gjuhën amtare, ndërkohë që partia e Dulës po bën mbi dhjetë vjet në pushtet, atëherë nuk është e logjikshme të pyesim se kujt i shërbën zoti Dulja. Në rast se për përfitime politike dhe personale nuk e ka për gjë të kthehet politikisht herë nga e majta e herë nga e djathta, loja të ngjashme për çeshtje si kjo e Himarës e kanë koston shumë të rendë, aq sa nuk ka kurrfarë rendësie nëse i faturohet atij.

E rrezikshme se tani ky “yll” duket se nuk po “i ndriçon rrugën e tij” dhe jo vetëm aq. Ai e kupton se fatura e dështimit do t’i mbetet atij dhe ai e di shumë mirë sa peshon dhe çdo të thotë një faturë e tillë. E rrezikshme është se me këtë logjikë po t’i kerkohet nëser që gjuha greke të mos përdoret publikisht dhe në fshatin e tij në Goranxi, ai do ta pranojë. E rrezikshme është dhe për faktin se me këtë taktikë ai i ve marrëdhëniet shtetërore në lidhje me Himarën në raporte mashtrimi që mbjellin mosmarrëveshje dhe konflikte dhe, ashtu si për shumë çeshtje të tjera në lidhje me minoritetin etnik grek në Shqipëri apo dhe për probleme të tjera midis dy vendeve, lëjon të shtohen paqartësitë dhe qëndrimet e dyzuara dhe të kundërta. E rrezikshme se krijon premisa për marrëdhënie konfliktive midis anëtarëve të shumicës dhe pakicës në vend. Nga ana tjetër edhe kjo situatë e krijuar herë pas here në Himarë i shtohet frymës së psikozës negative dhe presionit në të gjithë komunitetin e minoritetit etnik grek në

Shqipëri, frymë që buron nga ekuivalentimi i gabuar i reciprocitetit, sidomos negativ, në marrëdhëniet bilaterale. P.sh del në sipërfaqë problemi i emigrantëve shqiptarë në Greqi, mënjëherë ekuivalenti kërkohet te minoriteti grek. Shtrohet problemi çam, hapur ose mfshehtas analogohet me minoritetin etnik grek. Madje shkohet aq larg sa edhe minoriteti musliman i Trakës në Greqi të krahasohet me minoritetin etnik grek në Shqipëri Pra po lëjohet shumë mjegull dhe për shumë probleme. Nga kjo mund të përfitojnë ca Dule, por nëse do të lëjohet kjo situatë e ardhmja do të korr erresirë dhe konflikte.

Panajot Barka Për gazetën Albania, 21.01.2007 u Botua të henen 23.01.2007 eshte e arshivuar)

nga P. Barka.

Berisha e mashtroi për president, Nanua kërcenon dhe zbulon natyrën e vet dhe të politikës shqiptare

07.04.2007

Të enjten që sapo shkoi në TV Klan u shfaq edhe një herë Fatos Nano. Si asnjëherë tjetër ai ishte Nanua prej vërteti. Nuk do të përbënte shkas për komente të rëndësishme nëse shfaqja e tij kësaj here nuk do të lidhej drejtpërdrejt demarshin e tij për postin më të lartë politik në vend. Kjo për faktin se arriti të përcjellë te publiku në mënyrën më të hapur dhe më sfiduese thelbin e politikës dhe të politikanit tonë. Thjesht ishte arrogant dhe kërcenues, hipokrit e demagog. Dhe aspak në nivel personal, gjithçka në emer të realizimit të qëllimit personal, atë të shijimit të postit të koltukut të presidentit.

Së pari, ai u vetshpall kandidat për president. (Ndryshe nga logjika politike në vend, -rasti i B. Topit,- që e propozon partia e tij dhe aq me tepër kur situatat janë të tilla që kërkojnë konsensus partiako-politik). Nanua na deklaroi se, ndryshe nga herët e tjera, që do të thotë të zgjidhet president “me pazare”, kësaj here kërkoi t’i imponojë opozitës emrin e tij për kandidatë. Nanua e bën këtë nga njëra anë se e di shumë mirë se vetëm kështu mund të funksionojë logjika e presidentit konsensual dhe shmangja e zgjedhjeve të parakohshme. Nga ana tjetër e kupton se shanset për “pazaret” kësaj here janë me propabilitet të për të ulët, si përsa i përket sigurimit të korumit të votave, ashtu dhe për shkak të nevojës së konsensusit politik.

Për këtë arsye ai kërcenoi se po nuk u zgjodh ai president, Partia Socialiste do të shpërbëhet. Pra, ai është i gatshëm që të shkatërrojë edhe atë për të cilin ai pretendon se përbën kredibilitetin e tij politik. Paralelisht, ka gati dhe akuzën për tua faturuar të tjerëve këtë akt të mënxyrtë,-lidërshipt aktual.

Kërcenoi paralementin me bllokim punimesh dhe vendin me stanjacion ose kthim prapa në rrugën e reformave dhe procesëve integruese Euroatllandike.

Pra, së dyti, me dashje ose pa dashje na pohoi se është pikërisht ai (dhe alterego-ja e tij, të cilit, me elokuencë arrogante i bëri “osana” në shfaqjen e tij publike pikërisht në TV KLAN), që mbajnë nën kontroll kacakët e stuhive në vend, përplasjeve, krizave, ngecjes se vendit në ecjen e gaforës. Pra, na vertetoi se ata janë shkaktarët dhe përgjegjësit kryesorë për rrugën e mundimshme të vendit në proceset demokratike. Ata e përdorin me egërsinë më të madhe abuzive dhe në mënyrë të patolerueshme forcën politike që u jep vota e popullit dhe postet politike të përfituara nga kjo votë, për të venë në shërbim të interesave të tyre personale çdo strukturë shtetërore, ekonomike e politike të përfaqësuar prej tyre.

Së treti, i doli në krah kryeministrit Berisha duke i servirur alibinë më të qenësishme për të kundërshtuar arsyen reale dhe domosdoshmërinë historike që pas Nanos edhe Berisha duhet të largohet nga politika. Nano me arrogancë, na tha se Berisha është faktori më i votuar në vend dhe të gjitha ata që kërkojnë largimin e tij, janë analfabet në politikë dhe jashtë realitetit. Më këtë rast, ai, Nanua, krijoi edhe për vete alibinë se zgjedhjet e korrikut të 2005 nuk i shiti ai te Berisha për interesat e veta dhe kërkoi të shtojë tek “shkaktarët” për fitorën e Berishës pas Metës edhe Ramën.

Shitja e zgjedhjeve të korrikut të 2005 përbën na fakt aktin e fundit të bashkëpunimit nën rogoz të Nanos dhe Berishës. Që nga ky moment e në vijim ata bashkëpunojnë hapur. Më këtë rast, nga njëra anë na zbulojnë se të gjitha akuzat e ndërsjellta publike nga më të egrat, të gjitha “përpjekjet” për të denuar dhe ndjekur njëri - tjetrin ishin demagogji ose pjesë e maskimit në publik të bashkëpunimit të hidhur në dëm të

interesave të demokracisë dhe të votuesve shqiptarë. Pra ishin dhe janë pjesë e të njëjtit moçal, faktorë që nëpërmjet këtyre formave të bashkëpunimit kishin përqëndruar në duart e tyre (përshtetë), peshën e të gjithë shtetit me pasojë mosfunksionimin e tij asnjëherë. Nga ana tjetër, nëvoja për një bashkëpunim tanimë të hapur midis tyre, tregon shkallën e madhe të pamundësisë për të mbijetuar në politikë dhe sa më shumë janë pjekur kushtet që ata të dy dhe praktikat e tyre drejtuese të dalin nga përdorimi politik.

Së katërti më demagogjinë komuniste të përmallimit dhe vuajtjes për fatet e atdheut dhe të popullit Nanua na shpalosi “projektin” e tij për të ardhmën e Shqipërisë. Foli në fakt për ato gjëra që për tetë vjet i kishte në dorë dhe nuk i bëri. Përkundrazi! Po ashtu atij iu dhanë, më shumë se çdo njëri tjetër, mundësitë që të rivinte në krye të punëve të shtetit dhe nuk bëri asgjë nga ato që premtonte dhe i ripremtoi.

Në këto rrethana për haxhi qamilet që Nanua solli në politikën shqiptare dhe tani pa pikë përgjegjshmerie dalin dhe deklarojnë se pavarësisht nga qëndrimi politik i partisë së tyre ata do ta votojnë Nanon-president, shtrohet një pyetje e thjeshtë: Nëse vertet Nanua zgjidhet president kush na garanton se ai do të respektojë protokollin e postit dhe nuk do të duhet që për një firm të nomeklaturës së presidentit nuk do të duhet marrë me radhë hotelet luksoze jashtë vendit!?

Por nga ana tjetër kandidatura e Nanos për president, përderisa nuk mund të jetë konsensuale brenda rradhëve të opozitës, objektivisht do të çojë në thellimin e polarizimit dhe drejt përçarjes së saj. Aq më tepër po të kemi parasysh mjetet që kanë në kontroll vet Nanua dhe deklaracionin me cinizën se janë efektive për të realizuar interesat e tij.

Po ashtu, në kambin blu, në kushtet e lojës me dhe pa top i Berishës për vite me radhë, dalja në treg e emrit të B. Topit për postin e presidentit nuk mund të lejohet të kalojë pa pasojat të rënda “në unitetin e çeliktë” të rradhëve të PD-së. Pra, dosja e re (çështja e presidentit) me kapakë blu dhe me fletë rozë me protagonist Nanon dhe Berishën duket se nuk mund të funksionojë më.

Si zgjidhje e vetme do të ishte: Arritja e konsensusit për zgjatjen e mandatit të presidentit aktual, imponimi (në rast se nuk ka konsensus) të një qëverie teknike me afat kohor të përcaktuar brenda të cilit kjo qëveri do të mirrte përsipër reformat e duhura kushtetuese e zgjedhore si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme me këtë strukturë ligjore e qëverisëse si dhe zgjedhja e presidentit.

P. Barka, Gazeta ALBANIA 07.04.2007 u botua te nesermen

Pushteti politik i Berishës dhe tjetërsimi në emër të tij të pasurisë pronësore, -rasti i Himarës dhe Bregut

22.04.2007. u botua me 24.04.2007 fq 1-10

Δuo άρθρα που δημοσιεύτηκαν με μικρές συντομεύσεις στην εφημερίδα ΑΛΒΑΝΙΑ στις ημερ. 24 και 25.04.2007



Në gamën tëpër të gjerë të konflikteve të hapura nga kryeministri Berisha në një hark kohor tëpër të shkurtër, konflikti në Jalë ka, përveç anëve të përbashkëta me konfliktet e tjera edhe anë me interes të vëçantë.

Larmia e konflikteve po vertetohet më së miri nxitimin e Berishës për të kaluar nën kontrollin e njëzëve të tij ato veprimtari, private apo publike, që garantojnë përfitime ekonomike pa hesap, por që në një mënyrë ose një tjetër vazhdojnë të jenë në duar

të tjera. Paralelisht synon prishjen e bazës sociale dhe elektorale të kundërshtarëve të tij politikë, (ose, duke abuzuar me pushtetin ekzekutiv, t'u imponojë mbeshtetësve të opozitës përkrahjen ndaj tij). Në arritjen e këtij qëllimi i duhet sigurimi i heshtjes duke eliminuar mjetet e reagimit, apo të përçimit të reagimit, siç janë medjat dhe fjala e lirë. Duhet gjithashtu venë re se kjo ofensivë konfliktesh vjen menjëherë pas dështimit të Berishës për të shtënë nën kontroll institucionet shtetërore të pavaruara, të cilat do t'i kishin siguruar me kohë dhe pa zurmë synimet e lartëpërmenduar.

Nxitimi i Berishës, në dukje i pakuptimtë, është objektiv po të kemi parasysh logjikën e njëshit të qeverisë dhe zhvillimet politike në vend.

Së pari, ai ndodhet nën presionin e mbështetësve të tij të cilët shpresuan se të nësërmën e marrjes së pushtetit do të hanin me lugë të artë dhe do të laheshin në vaska floriri. Tani ata shikojnë se po mbësin me gisht në gojë ndërkohë që një grup i vogël njëzëzish rreth Berishës nuk mjaftohen vetëm duke futur gishtin me mjalt por tentojnë gjithë qypin.

Së dyti, ky nxitim lidhet me faktin se në horizont duken zgjedhjet e parakohshme. Për to më i interesuar se kushdo është vet Berisha. Atij nuk i intereson kushti president konsensual. Kjo do të thotë një emër i imponuar nga opozita që nuk do t'i lejojë serish Berishës të vë dorë mbi drejtësinë dhe institucione të tjera të pavarura, apo të aprovojë ligje në shërbim vetëm të asaj mazhorance të përfaqësuar nga klanet e tij. Zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme si rrugë të vetme shpëtimi për karrierën e vet politike, ai e lidh me fitorën me çdo kusht. Dihet nga të gjithë se realizimi i këtij kushti kërkon sa më shumë përkrahës nga ata që kontributin e tyre paraelektoral e lidhin me përfitimin e pamerituar që rrjedh nga ndarrja e pushtetit. Mirëpo, ata nuk u kanë parë hajrin premtimeve të para edhe pse kanë kaluar gati dy vjet. Kështu që ai do të nxitohet t'i kënaq sado pak. Do ta bëjë këtë edhe për të mos lëjuar çarjet e mëtejshme brenda partisë së tij dhe koalicionit të vet qeverisës

Së treti me këto veprime që kanë në thelb konfliktin, Berisha kërkon njëkohësisht të tërheq vemendjen nga kërkesa themelore për reformat e kërkuara dhe të premtuara,

sidomos nga reforma zgjedhore. Çuarja e vendit në zgjedhje të parakohshme me ligjin e egzistues elektoral, bile pa marrë parasysh dhe amedamentet e bëra në janar 2007, (rasti i Shijakut ishte prova e parë), i lëjon Berishës të kalkulojë në tavolinë një fitore elektorale që, pse jo, mund të garantojë edhe zgjedhjen e tij në postin e presidentit. (!!!) **Rasti Jalë është një konfirmim absolut i kësaj situatë.** Pas referimeve në zbatim të ligjit, duken “projekte” pas të cilave fshihen emra familjarë të vet kryeministrit. Rasti Jalë, ashtu si rasti Ksamil pak muaj më parë, apo shfaqja e fadromave të qeverive socialiste disa herë në Himarë apo dhe në Kakome, kanë në thelb: së pari prishjen e objekteve (me ose pa leje) për të përfituar drejtpërdrejt dhe për vete nga një pjesë të kësaj perle poseduesit e rinj të pushtetit, qoftë ai lokal, qoftë ai qendror.

Së dyti, në emër të integritimit të zonës në turizmin botëror, poseduesit e pushtetit politik duan të bëhen partner me aksione private në këto ndërmarrje. (Në të dyja rastet një hulumentim qoftë edhe sipërfaqësor na verteton se ata që dërgojnë fadromat për të prishur objektet në këtë zonë, apo për të mbajtur pezull ndarjen e pronave, apo për të falsifikuar dokumentet mbi pronësinë e trojeve, janë pushtetarë që në emer të shtetit kërkojnë pjesë për vete në vendet më të bukura të kësaj pjese të Rivjerës. Ata që protestojnë në emer të interesave të banorëve për shkelje të ligjit, e bëjnë këtë duke u nisur fillimisht nga interesat e tyre. Kërkojnë t’i mbrojnë ato duke akuzuar strukturat e shtetit për shkelje të ligjit në dëm të banorëve pronarë të ligjshëm të atyre pasurive, ose në dëm të interesave të krahinës në terësi.)

Po vërtetohet gjithashtu fakti aq i përfolur se ngjyrat nacionaliste për zgjedhjet (lokale apo politike) në Himarë dhe në zonën me të gjerë të Bregut deri në Sarandë, shërbejnë si mjergull për planet dhe qëllimet e individëve të pushtetshëm, që në emer të patriotizmit, të bëhen pjesëtarë në shpërndarjen dhe rishpërndarjen e vlerave turistike të kësaj zone.

Nuk mund të vihet gjithashtu në dyshim se ofensiva disa vjeçare në emer të zbatimit të ligjit në këtë zonë ka si qëllim minimizimin dhe eliminimin e rolit të banorëve autoktonë (me kuptimin vendas) në mbarëvajtjen dhe përfitimin nga turizmi në këtë zonë. Mendojmë për një çast se cili do të jetë roli dhe mundësia konkurrese e banorëve vendas në turizmin e zonës nëse në këtë zonë do të ndërtohen 4-5 fshatra turistike të administruar nga të huajt me pjesëmarrjen e individeve që përfaqësojnë pushtetin politikë në vend. Cili do të jetë roli i tyre kur një pjesë tjetër të aktivitetit turistik e kontrollojnë grupet që pastrojnë parat e pista dhe ato të krimin të organizuar, apo dhe faktorë të tjerë.

Po t’u referohemi faktëve dhe realitetit do të vemë re se kjo strategji ka vite që aplikohet, bile edhe me synime më të diferencuara.

Kështu p. sh. në një kohë që në Shqipëri, sipas deklaratave të kryeministrit Berisha, ndërtimet pa leje kapin vlerën e mbi pesë miliardë Evrosh, fadromat e policisë ndërtimore kanë goditur në mënyrë të përsëritur vetëm në këtë pjesë të vendit. Himarë, Ksamil, Butrint, Kakome dhe tani Jalë ndërsa janë futur në rreth të kuq Vunoi, Palasa dhe Dhermiu (Çfarë imuniteti zotërojnë ndërtimet pa leje, bile më të bezdisura, në plazhet e Vlorës, Divjakës, Durrësit, Shengjinit, Velipojës etj të cilat nuk janë bërë kurrë objekt i policisë ndërtimore!?) Përsa i përket diferencimit që thamë disa herë u vu re që në ekspeditat “ndëshkimore” për prishjen e ndërtimeve pa leje në zonat e Bregut të Jonit të përmendura më lart, përzgjidheshin kryesisht objektet e minoritarëve grek, atje ku kishte dhe ndonjë objekt tjetër të qytetarëve të tjerë shqiptarë. Pasi ato shkatërroheshin, fadromat largoheshin për të ardhur serish kohë pas kohe me të njëjtën taktikë, logjikë dhe qëllim.

Në këtë kendveshtrim nuk mund të mos vemë re se kjo strategji lidhet me faktin se zhvillimi i turizmit në anën tonë të Jonit është objektivisht i detyruar të konceptohet jo

si konkurues me turizmin në Kurfuz dhe në brigjet analoge greke por si komplementar dhe bashkëpunues. Këtë perspektivë zhvillimi të turizmit në këtë rajon duket se e pengon elementi grek në të dy anët e kësaj pjese të Detit Jonë. Kjo për faktin se, në planin etnik, nuk jep garanci se mund t'i rezistojë ndikimit grek edhe elementi shqiptar vendas, qoftë ai në shumicë. Kështu që më e udhës është që ky element të shmanget nga roli primar në turizmin intensiv dhe integruet në këtë zonë. Pra, një analizë e thelluar na çon në përfundimin se në këtë pjesë të Bregdetit të Jonit kemi një larmi konfliktesh dhe interesa ku të ekspozuar para rrezikut dhe të pambrojtur nga ligji janë banorët vendas dhe zhvillimi i turizmit të vertet, intensiv, bashkohor dhe të integruar.

Panajot Barka. Gaz. ALBANIA/ 22.04.2007. u botua me 24.04.2007 fq 1-10

Nga Panajot Barka

Minoriteti Etnik Grek, po mirret pengë i interesave nacionaliste shqiptare që u intereson defaktorizimin e tij.

(Ku kullot kali i Trojës)

24.04.2007



Të dielën që shkoi, më 22.04.2007, emisioni “Exclusive” të Top Channel nën titullin “Kali i Trojës” bëri një përpjekje për të revokuar ngjarjet që sollën marrëdhëniet më të veshitura midis Shqipërisë dhe Greqisë dhe shtetit shqiptar me minoritetin grek në Shqipëri. Bëhet fjalë për pervjetorin e 13-të të incidentit të Peshkëpisë i cili shënoi dhe fillimin e kulmimit të

përkeqësimit të këtyre marrëdhënieve. Ne që i përjetuam me dhimbje dhe stoicizëm ato ngjarje prisnin nga emisioni të na jipte edhe pogramin e shtetit të atëhershëm ndaj minoritetit grek. 22 prilli i 1994 shënoi kulmin e ofensivës së strukturave shtetërore të dhunës me në krye SHIK ndaj minoritetit grek në Shqipëri. Mbi 250 kuadro, intelektual dhe drejtues të këtij minoriteti u dëportuan në rajonet dhe komisariatet e policisë. Disa syresh u arrestuan, pesë u burgosen dhe dolën para gjyqit. Me dhjetra shtëpi u bastisen natën. Dhunshëm dhe pa asnjë proces-verbal u bastisën të gjitha zyrat e OMONIAS, dokumentet arkivore të sëcilës ende nuk janë kthyer. Me qindra anëtarë të këtij minoriteti, burra dhe gra iu nënshtuan hetimeve brutale duke iu shkelur të gjitha të drejtat me pasojë marrjen e deklaratave dhe dëshmime të diktuar.

Ajo që duhet shënuar gjithashtu, si diçka e pashlyer për kujtesën dhe ndergjegjen e minoritetit grek, është fakti se ky minoritet kishte në krah të tij mbeshetjen e plotë dhe të gjithanshme të popullit shqiptar, të medjas, të partive politike të opozitës, madje dhe të strukturave të vëçanta të shtetit. Ishte një manifestim i shkëlqyer tolerance, bashkëjetese, integrimi e solidariteti. Ndaj, mendoj se evokimi me këtë sens të këtij realiteti të para 13 vjetësh, do të ishte një shërbim i mirë në rrugën integruese Euroatlantike që ka hyrë Shqipëria. Por kjo u harrua nga të gjithë, madje dhe nga vet OMONIOIA apo PBDNJ-shi. Top Channel-i që e përkujtoi, u nis nga paragjykimet e njohura nacionaliste të fillim shkullit të kaluar dhe të luftës së ftohtë, të trajtimit të minoritetit etnik grek në Shqipëri si një “kal-troje në shërbim të synimeve aneksoniste greke ndaj Shqipërisë”.

Kurrorëzimi i këtij argumenti të vjetër ishte deklarata “e re” e kryebashkiakut të Himarës dhe nënkryetarit të OMONIAS Vasil Bollano. Siç mësohet, në këtë emision u shkeput një pasazh nga një intervistë e Bollanos së para dy muajve ku thotë se “... di që OMONIA e ka kërkuar vazhdimisht atë. Ne nuk duam më shumë se ç’kërkon Shqipëria për Kosovën. Kjo është në të mirë të Ballkanit dhe të pakicave greke në Shqipëri”. (!?)

E gjithë kjo, përvoja e djetëvjeçarit të shkuar, bashkë me përpjekje të tjera në medjat shqiptare për të parë Greqinë si një vend dashakeq dhe jo miqësor ndaj Shqipërisë, krijon arsye të mjaftueshme për të ngritur pikëpyetje dhe pikëçuditëse, në lidhje deklaratën e Bollanos. Pse të nësërmën e emisionit “Excluzive”, Bollano doli në

